



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 179

Tiranë – E mërkurë, 19 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 121, datë 13.12.2018	Për emërimin e një anëtari të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)..... 12245
Dekret i Presidentit nr. 10989, datë 7.12.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12245
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 12.12.2018	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për ushtrimin e veprimtarisë së organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të një pjese të katit të parë dhe të katit të dytë në objektin nr. 14, të pronës nr. 12, me emërtim “Komanda e Doktrinae dhe Stërvitjes”, me vendndodhje Rruga e Dibrës, Tiranë..... 12245
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 12.12.2018	Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri..... 12248
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 37, datë 4.12.2018	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 29, datë 10.9.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 12266
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 861, datë 13.12.2018	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, të ndryshuar..... 12266
Vendim i Komisionit të Votimit pranë Gjykatës së Lartë nr. 242, datë 12.12.2018	Për shpalljen e kandidatëve fitues për anëtarë gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor..... 12267

**VENDIM**
Nr. 121/2018**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË
BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Raimonda Islamaj emërohet anëtare e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 13.12.2018

DEKRET
Nr. 10989, datë 7.12.2018**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tij, personit të mëposhtëm:

Luciano Quintino D’Alfonso.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 741, datë 12.12.2018**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TË
MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
ORGANEVE TË QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË, TË NJË
PJESË TË KATIT TË PARË DHE TË
KATIT TË DYTË NË OBJEKTIN NR. 14,
TË PRONËS NR. 12, ME EMËRTIM
“KOMANDA E DOKTRINAVE DHE
STËRVITJES”, ME VENDNDODHJE
RRUGA E DIBRËS, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 3, të neneve 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Drejtësisë, për një periudhë 25-vjeçare të një pjese të katit të parë, me sipërfaqe 1057 (një mijë e pesëdhjetë e shtatë) m² dhe të katit të dytë, me sipërfaqe 1882 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) m², me sipërfaqe të përgjithshme 2939 (dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) m² në objektin nr. 14, të pronës së paluajtshme shtetërore nr. 12, me emërtim “Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes”, me vendndodhje Rruga e Dibrës, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për sistemimin me mjedise pune dhe ushtrimin e veprimtarisë së organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) etj.

2. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqeve të objektit të dhënë në përdorim të përkohshëm, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet të kryejë ndryshime infrastrukturore ose ndërtime të reja, në objektin e dhënë në përdorim të përkohshëm, pa



shpërblim, pa miratimin paraprak të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Të drejtat dhe detyrimet e palëve duke përfshirë ruajtjen dhe sigurinë e pronës, mënyrën e zbatimit të rregullave të hyrje-daljeve të personelit dhe të mjeteve mënyrën e përdorimit e të mirëmbajtjes së rrjeteve inxhinierike, të linjave të komunikimit elektronik dhe të furnizimit me ujë, energji elektrike e linjave të tjera në përdorim të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të

nënshkruhet marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MIRATOHEM
KOMANDANTI REPARTIT USHTARAK 6630



PRONA NR.12 KOMANDA E DOKTRINES DHE STERVITJES
GODINA NR. 14
PLANIMETRIA E KATIT I
SIPERFAQE PER DHENIE PER PENDORIM 1057 M²





PRONA NR.12 KOMANDA E DOKTRINES DHE STERVITJES
GODINA NR. 14

PLANIMETRIA E KATIT 2


SIPERFAQE PER DHENIE PER PERDORIM 1882 M²

MIRATOHET

KOMANDANTI REPARTI USHTARAK 6630



KOLONEL ARBEN KRASNIQI



SHEJTI

PRONA NR.12 KOMANDA E DOKTRINES DHE STERVITJES	
GODINA NR. 14	
PLANIMETRIA E KATIT 2	
SIPERFAQE PER DHENIE PER PERDORIM 1882 M ²	
MIRATOHET	
KOMANDANTI REPARTI USHTARAK 6630	
KOLONEL ARBEN KRASNIQI	
A-01	

**VENDIM****Nr. 742, datë 12.12.2018****PËR MIRATIMIN E PLANIT
STRATEGJIK PËR REFORMIMIN E
SEKTORIT TË ENERGJISË
NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****PLANI
STRATEGJIK PËR REFORMIMIN
E SEKTORIT TË ENERGJISË
NË SHQIPËRI****Hyrje**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është angazhuar shumë, nga njëra anë, të rrisë kapacitetin prodhues, ndër të tjera, nëpërmjet ndryshimit të përzierjes prodhuese dhe, nga ana tjetër, të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të energjisë në vend si në aspektin e sigurisë së furnizimit dhe cilësisë. Këto angazhime vijnë në formë të ndryshme nga kontratat ndërkombëtare, si dhe përmes përpjekjeve të vazhdueshme për të ristrukturuar të gjithë sektorin e energjisë elektrike.

Prandaj, Shqipëria është në proces të ristrukturimit të mjedisit rregullator. Ky ristrukturim do të ketë një nënkuptim të rëndësishëm për sektorin e energjisë elektrike dhe palët e interesuara. Kuadri i ri ligjor dhe rregullator synon të adresojë një gamë të gjerë të çështjeve të sektorit të energjisë, duke përfshirë reformat institucionale, nxitjen, rritjen e efikasitetin e energjisë dhe kapacitetin prodhues

të energjisë së rinovueshme në Shqipëri, krijimin e sistemit të ri të tarifave të energjisë elektrike, zhvillimin dhe vendosjen e një tregu të organizuar të energjisë elektrike dhe integrimin e një tregu shqiptar të energjisë elektrike me tregjet më të gjera rajonale të energjisë elektrike dhe së fundi tregun e brendshëm të energjisë elektrike të BE-së.

Kapaciteti prodhues i instaluar i Shqipërisë është mbi 2.01 GW dhe mbizotërohet tërësisht nga hidrocentralet. Për më tepër, tregu shqiptar i energjisë elektrike është subjekt i një sasive të kufizuar të palëve kryesore të interesuara. Aktorët e tregut të energjisë aktualisht po bashkëpunojnë në një mjedis me transparencë të kufizuar që pengon hyrjen në treg të aktorëve të rinj dhe lidhet me mungesën e efikasitetit në këtë sektor. Një përpjekje reforme filloi në vitin 2006 me anëtarësimin në Komunitetin e Energjisë dhe u rifreskua në vitin 2015 me miratimin e një ligji të ri për sektorin e energjisë elektrike (PSL) nr. 43/2015. Ndërkohë që reforma është ngadalësuar pak gjatë dy viteve të fundit. Në muajt e fundit Këshilli i Ministrave dhe aktorët kryesorë kanë gjetur energji të rinovueshme për të vazhduar me reformën sektoriale.

Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se Shqipëria po ndërmerr tashmë hapa reformash, të cilat mbështeten në reformën e sugjeruar këtu. Hapat e reformës përfshijnë, ndër të tjera, hapin e parë drejt ndarjes së OSHEE-së, furnizuesit të vetëm e universal të Shqipërisë, dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, krijimin e një shoqërie shqiptare të shkëmbimit të energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues me shumicë. Ky treg i shitjes me shumicë, krahas tregtisë dypalëshe, ku marrëveshjet bëhen drejtpërdrejt nga tregtarët (*Over-the-Counter OTC*) & tregtisë derivative (*forward*), pritet të përfshijë tregjet e ditës në avancë (*day-ahead*) dhe brenda ditës, si dhe tregun e balancuar të energjisë elektrike, ku formimi i çmimeve pritet të jetë i formuar lirshëm mbi bazën e mungesës së mallrave, konkurrencës dhe nevojave për investime, d.m.th. vlerësimin e vërtetë ekonomik të energjisë elektrike.

Plani që miratojmë këtu ka për qëllim të përdoret si një mjet për të krijuar një rrugë të qartë për reformimin e të gjithë sektorit të



energjisë elektrike në Shqipëri. Ky është një dokument thelbësor si pjesë e instrumentit të huave të bazuara në politikat e reformës (PBL). Huatë e bazuara në politikat e reformës (PBL) janë një mjet në të cilin fondet nga një institucion financiar ndërkombëtar i japin hua një operatori publik të tregut në bazë të zbatimit të reformave specifike të politikave të renditura në këtë plan strategjik (PRE).

Plani strategjik paraqet një reformë të gjerë për sektorin e energjisë. Reforma shënjestron kanale të shumëfishta, si: strukturore, operationale dhe financiare. Për më tepër, duhet të theksohet se plani strategjik shqyrton dhe zbaton angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me procesin e anëtarësimit në Komunitetin e Energjisë dhe në BE.

Si e tillë, reforma e sugjeruar e përfshirë në planin strategjik përfshin një listë gjithëpërfshirëse të masave (PRE). Nëse zbatohen këto reforma, duhet të krijojnë një treg të organizuar në modelin e BE-së, i cili udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm në një periudhë të gjatë, bazuar në formimin e çmimit të lirë përmes konkurrencës. Përpjekjet kyçe që përmban kjo reformë mund të përmbledhen gjerësisht si: Ndarja vertikalisht e kompanisë së integruar të shpërndarjes OSHEE, qasja transparente dhe jodiskriminuese (dhe tarifat) për sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, një rregullator i fortë i pavarur, çmime të vendosura në mënyrë të pavarur, konkurruese dhe transparente, si dhe skemave të mbështetjes për kategori vulnerabel të drejta, transparente, jodiskriminuese dhe minimale në mbështetje të tregut për klientët në nevojë të shoqërive dhe për prodhuesit e energjisë së rinovueshme.

Përfitimet e reformës së propozuar mund të përmbledhen si krijimi i një tregu që prodhon, transmeton dhe konsumon energji elektrike në mënyrë efikase, si dhe një treg që ndërmerr investime që realizojnë fitimet më të larta. Shkurtimisht, përfitimi kryesor i reformës është krijimi i një tregu që mundëson vlerën e shtuar më të mirë për paratë publike.

Megjithatë, është e rëndësishme të njohim, gjithashtu, rrezikun që lidhet me reformën. Rreziku i parë potencial për t'u theksuar është një implementim i paplotë ose i pasaktë i planit strategjik të propozuar. Pasoja do të ishte një treg

gjithnjë e më i ndërlikuar dhe kompleks, si dhe një treg që nuk ofron përfitimet e dëshiruara dhe vazhdon të përhumet nga skemat e subvencionimit jotransparent dhe diskriminues, që në afat të gjatë krijojnë kosto të tepër për tregun. Rreziku i dytë i rëndësishëm për t'u theksuar është përfshirja me bazë të gjerë në reformë, duke filluar me mungesën e pronësisë nga ministria përkatëse e linjës (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Kjo do të thotë se, nëse aktorët e brendshëm nuk kanë interes për zbatimin e reformës, si rezultat i mungesës së pronësisë së brendshme, atëherë reforma e propozuar nuk do të zbatohet në tërësi dhe kështu do të rrisë gjasat për rrezikun e parë. Një shembull i kësaj mungese interesi për të zbatuar një reformë, të paktën brenda afatit kohor, është dhënë nga përvoja me derregullimin e paralelizuar plotësisht me metodologjinë e çmimeve. Është e rëndësishme ta marrin seriozisht këtë rrezik dhe në përputhje me rrethanat të merren masat e duhura për ta kundërshtuar atë. Së fundi, një sfidë kyçe është komunikimi si me publikun (konsumatorin fundor), ashtu edhe me palët e interesuara. Pra, reforma ka të ngjarë të çojë në çmime më të larta, që mund të rezultojë në disa shqetësime publike. Megjithatë, do të jetë thelbësore për të komunikuar se çmimet për energji elektrike janë vetëm më të larta në sipërfaqe, d.m.th. çmimet aktuale të ulëta subvencionohen përmes taksave dhe buxhetit të shtetit në një mënyrë të vështirë dhe të ndërlikuar dhe në të njëjtën kohë rezultojnë në nëninvestime në infrastrukturë, duke dërguar një faturë gjithnjë në rritje për furnizimin me energji për brezat e ardhshëm. Për më tepër, reforma, si e tillë, parashikon krijimin e skemave të përkohshme dhe të përhershme mbështetëse për akomodimin e interesave të grupeve në nevojë nga ndikimet negative të reformës dhe “varfërimin nga energjia” - e thënë ndryshe “efektet që sjell ndryshimi me rritje i çmimit të energjisë elektrike”, si dhe mbështetjen e prodhuesve të energjisë së rinovueshme. Megjithatë, skema të tilla mund dhe duhet të zbatohen vetëm në mjedisin e ri të parashikuar të tregut, pasi të jetë krijuar dhe të ketë funksionuar në mënyrë të mjaftueshme për të shmangur shtrembërimin e mekanizmit të formimit të çmimeve të tregut, d.m.th. vlerësimin e saj të mallrave në bazë të mungesës, konkurrencës dhe nevojave të investimit.



Së fundi, duhet të theksohet se plani strategjik aktual përmban disa masa reformuese që tashmë janë duke u zbatuar ose reflektuar edhe në PSL. Megjithatë, këto masa duhet të përfshihen në këtë plan strategjik në mënyrë që kjo të përbëjë një koncept gjithëpërfshirës për reformimin e sektorit të energjisë me zbatimin e elementeve përkatëse (PRE).

Udhëzuesi i huave të bazuara në politikat e reformës (PBL): Elemente të politikave të reformës për reformën e sektorit të energjisë në Shqipëri

Ky plan strategjik përmban elemente të reformës (PRE), të cilat duhet të realizohen nga autoritetet shqiptare dhe subjektet kyçe të sektorit elektroenergjetik për të finalizuar përpjekjet e reformës në sektor që u nisën disa vite më parë. Planin strategjik dhe veçanërisht koha e hapave të reformës janë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë dhe hapat e ndërmarrë për përmirësimin e qëndrueshmërisë ekonomike, mjedisore dhe sociale të sektorit. Nga kërkimi për gjetjen e fakteve, që përfshin intervista me palët e interesuara dhe vlerësimin e ekspertëve, në planin strategjik u përcaktuan elementet e politikave të reformës (PRE) të paraqitura më poshtë. Më saktësisht, së bashku me afatet e zbatimit, elementet e politikave të reformës përbëjnë planin strategjik. Ato janë të disajnuara në mënyrë të tillë që të formojnë bazën për një PBL që do të zbatohet gjatë periudhës 2018 deri në vitin 2020. PBL-ja do të përbëhet nga dy periudha, zbatimi dhe monitorimi, të cilat jo domosdoshmërisht do të korrespondojnë me vitet kalendarike. Periudha e parë pritet të fillojë në tremujorin e katërt të vitit 2018 dhe të vazhdojë deri në tremujorin e tretë të vitit 2019, ndërsa periudha e dytë është nga tremujori i katërt 2019 deri në tremujorin e tretë të vitit 2020. Afatet kohore gjatë të cilave elementet e politikave të reformës duhet të zbatohen përmbledhen në:

- Afati i parë i zbatimit;
- Numri i elementeve të politikave të reformës: 11;
- Kohëzgjatja: afërsisht 10 muaj;
- Afati kohor: 4Q2018 – 3Q2019 (ku Q i referohet tremujorshit);
- Afati i dytë i zbatimit;
- Numri i elementeve të politikave të reformës: 7;

- Kohëzgjatja: 12 muaj;

- Afati kohor: 4Q2019 – 3Q2020.

Shumica e elementeve të politikave të reformës janë në afatin e parë të zbatimit pasi ato janë të disajnuara për të promovuar elementet kryesore të reformave të cilat duken të realizueshme në vitin e parë dhe të cilat janë thelbësore të zbatohen përpara se të ndërmerren hapa të mëvonshëm. Zbatimi është realist dhe bazohet në kushtin që ka vullnet të mjaftueshëm politik pas zbatimit të reformës.

Sa i përket përmbajtjes së elementeve të politikave të reformës, ata janë, sipas projektimit, duke u fokusuar në elementet e reformës së nivelit të lartë të cilat janë vendimtare për një ristrukturim të suksesshëm të sektorit. Këto elemente të politikave të reformës do të realizojnë përmirësime institucionale në sistem, masat e bazuara në treg dhe zbatimin e praktikave të drejta dhe transparente në të gjithë zinxhirin e vlerës në sistemin e energjisë elektrike. Të gjitha këto elemente të politikave të reformës janë të domosdoshme për tregun relativisht të vogël shqiptar për të ofruar rezultatet e dëshiruara, veçanërisht në lidhje me formimin e çmimeve konkurruese në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë, likuiditetin e tregut, mbikëqyrjen rregullatore, interesat e ndara, pavarësinë politike të ERE-s, si autoriteti kombëtar i energjisë elektrike, dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

Shumë nga elementet e politikave të reformës varen nga njëra-tjetra, sidomos përgjatë dy afateve të zbatimit. Etiketimi numerik i elementeve të politikave të reformës nuk përbën një kusht në lidhje me zbatimin e elementeve të politikave të reformës brenda çdo afati të zbatimit, as nuk përcakton prioritetet e elementeve të politikave të reformës.

Zbatimi i elementeve të politikave të reformës për çdo afat përbën kushtin për disbursimin e elementit financiar të PBL-së. Pra, plani strategjik nuk bën asnjë supozim apo përjashtim në radhën e ndodhjes të elementeve të politikave të reformës. Më saktësisht, elementet e politikave të reformës që janë duke u zbatuar ende përfshihen në bazë të rëndësisë së tyre për suksesin e përgjithshëm të përpjekjeve të reformës. Sidoqoftë, edhe pse elementet e politikave të reformës janë aktualisht duke u zbatuar, ato janë

pjesë e kushteve për disbursim. Monitorimi i elementeve të politikave të reformës do të përfshijë vlerësimin që përcakton nëse sektori ka përmbushur kushtet dhe, për këtë arsye, kualifikohet për disbursim.

Megjithatë, para se të vazhdohet me prezantimin e elementeve e veçantë të politikave

të reformës është e rëndësishme të theksohen disa parakushte që duhet të jenë të vendosura përpara se plani strategjik të zbatohet. Këto parakushte mund të ndahen gjerësisht në dy kategori: parakushtet për zbatimin e suksesshëm të planit strategjik dhe parakushtet për vendosjen e shpërndarjen e suksesshme të PBL-së.

Tabela 1: Parakushtet për reformën

Parakushtet për planin strategjik	Parakushtet për huat e bazuara në politikat e reformës (PBL)
- Miratimi formal i planit strategjik nga Këshilli i Ministrave me qëllim krijimin dhe sinjalizimin publik të vullnetit të nevojshëm politik për zbatimin e reformës. - Angazhimi publik në lidhje me nevojën dhe përfitimet e reformës së propozuar. - Angazhimi i palëve të interesuara për të qartësuar rolet dhe pritshmëritë e tyre përkatëse. - Angazhimi me IFI-të (institucionet financiare ndërkombëtare) si për t'i mbajtur ato si mbështetje, por edhe për të bashkërenduar mbështetjen e tyre për reformën në veçanti, pasi tregu të jetë liberalizuar dhe derregulluar më tej.	- Miratimi i një memorandumit mirëkuptimi lidhur me PBL-në dhe kushtet për disbursim. - Krijimi i një skeme të qartë monitorimi. - Krijimi dhe mbajtja e roleve të qarta, përfshirë edhe operatorët publikë lokalë. - Ngritja e një skeme transparence dhe informimi brenda sistemit dhe me palët e interesuara.

Afati i parë i zbatimit 2018/2019

Tabela në vijim ofron një pasqyrë të elementeve të politikave të reformës të propozuara nga tremujori i katërt i 2018 deri në tremujorin e tretë 2019.

Nr.	Emri	Përshkrimi	Subjekti ekzekutues
1	Marrëveshja mbi vonesat dhe përmirësimi i pagesave nga subjektet publike	Gjetja e një zgjidhjeje për detyrimet e të papaguara në mes të subjekteve të ndryshme shtetërore	KM, MIE, MFE
2	Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE-së	Ristrukturimi i OSHEE-së në përputhje me kërkesat ligjore dhe funksionale të ndarjes dhe përgatitja për ofertë publike	KM, OSHEE, MIE, MFE
3	Miratimi i një procesi matjeje dhe parashikimi	Krijimi i një procesi dhe metodologjie të koordinuar të parashikimit, si dhe kërkesat teknike për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimeve	OSHEE, OST, KESH, ERE
4	Zbatimi i hapjes së tregut dhe derregullimit të çmimeve	Zbatimi i vendimeve lidhur me hapat që duhen ndërmarrë për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimeve, si dhe zbatimin e kontratës universale të furnizimit ndërmjet OSHEE-së dhe KESH-it (siç është përcaktuar në shtojcën 1 të Modelit të Tregut të PX-së, i miratuar me VKM-në nr. 519, datë 13.7.2016)	ERE, KM, MIE
5	Krijimi i një tregu shkëmbimi të energjisë	Vendosja ligjore dhe funksionale e shkëmbimit të energjisë në Shqipëri (APEX) në përputhje me Modelin e Tregut të miratuar dhe Rregullat e Tregut	OST, MIE
6	Zbatimi i mekanizmit dhe rregullave të balancimit të tregut	Zbatimi i mekanizmit të balancimit të tregut, me prokurim të hapur, transparent dhe jodiskriminues për rezervat balancuese bazuar në ofertën më të mirë	OST, ERE
7	Krijimi i operatorit RES dhe transformimi i <i>Feed-in-Tariffs</i>	Krijimi i kuadrit institucional dhe rregullator për marketingun e drejtë, transparent dhe jodiskriminues të energjisë së rinovueshme.	ERE, MIE



8	Ofertimi konkurrues për kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme	Zbatimi i ankandit të parë konkurrues dhe jodiskriminues për kapacitetet e reja të rinovueshme të prodhimit.	KM, MIE
9	Miratimi dhe zbatimi i skemës mbështetëse për konsumatorët në nevojë	Sigurimi që hapja e tregut dhe derregullimi i çmimeve të kenë ndikim minimal negativ ekonomik ndaj konsumatorëve në nevojë dhe familjeve që vuajnë nga liberalizimi i çmimit të energjisë elektrike. Përcaktimi i skemës së mbështetjes për këto grupe.	KM, MIE
10	Finalizimi i akteve nënligjore në përputhje me EnC <i>acquis</i> (Akt i Komunitetit të Energjisë)	Krijimi i kuadrit rregullator përmes akteve nënligjore që janë në përputhje me aktin e Komunitetit të Energjisë dhe ligjet e aplikueshme shqiptare.	ERE
11	Rritja e kompetencave dhe pavarësia e ERE-s	Forcimi i një rregullatori të pavarur i cili është në përputhje me direktivën e BE 2009/72/KE	ERE, MIE

Tabela 1: Vështrim i përgjithshëm i elementeve të politikave të reformës për afatin e parë të zbatimit
Elementi 1 i reformës së politikave:

Titulli: Marrëveshja mbi vonesat dhe përmirësimi i pagesave nga subjektet publike

Elementi 2 i reformës së politikave:

Subjekti ekzekutues	KM, MIE, MFE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Gjetja e një zgjidhjeje për detyrimet e papaguara ndërmjet subjekteve të ndryshme shtetërore
Përshkrim i detajuar	Grupi ndërministror i punës, i krijuar tashmë për këtë qëllim, do të finalizojë një marrëveshje që rregullon trajtimin e ardhshëm të të gjitha borxheve të pagueshme, ndërmjet kompanive shtetërore që lidhen me sektorin e energjisë elektrike, përfshirë subjektet publike me detyrime për energjinë elektrike. Përveç marrëveshjes, do të hartohet dhe miratohet një plan veprimi i cili do të sigurojë angazhimin për pagesën e faturave të energjisë elektrike nga të gjitha subjektet publike, duke përfshirë ato buxhetore dhe jobuxhetore. Plan i veprimit duhet të përmbajë objektivat e pagesave të sektorit publik, si dhe të përcaktojë një procedurë zgjidhjeje të ngërçit/dështimit (<i>fall-back</i> procedure) kur subjektet e sektorit publik mund të demonstrojnë paafësi (pamundësi) për të përmbushur objektivat e pagesës dhe ta raportojnë këtë te subjekti superior përkatës. Një strategji për përmirësimin e nivelit të pagesave nga subjektet publike duhet ta përmbyllë planin e veprimit. Së bashku, marrëveshja për pagesën e borxheve të prapambetura dhe plani i veprimit për pagesën e faturave të energjisë elektrike nga subjektet publike do të sigurojnë pastrimin e llogarive të arkëtueshme ndërmjet të gjitha njësive shtetërore. Duhet të theksohet se çështja e nivelit të pagesave korrente dhe pagesave të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike është e lidhur me nivelin e pagesave korrente dhe pagesat e prapambetura të detyrimeve në sektorë të tjerë. Prandaj, për të zgjidhur këto çështje në rastin e sektorit të energjisë elektrike është e këshillueshme që një zgjidhje gjithëpërfshirëse në sektorë të ndryshëm do të jetë e nevojshme.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	KESH, OSHEE, OST, ERE
Synimi i zbatimit	Gjetja e marrëveshjes së zgjidhjes
Matja e zbatimit	Dorëzimi i marrëveshjes së zgjidhjes



Titulli: Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE-së

Subjekti ekzekutues¹	KM, OSHEE, MIE, MFE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Ristrukturimi i OSHEE-së në përputhje me kërkesat ligjore dhe funksionale të ndarjes dhe përgatitja për ofertë publike
Përshkrim i detajuar	Ndarja ligjore e OSHEE-së si dhe ndarja e plotë funksionale do të zbatohen sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda periudhës së parë. Kjo do të përfshijë marrëveshjet përfundimtare dhe operacionale midis të gjitha kompanive të reja, duke përfshirë, por jo kufizuar në, ndarjen e asetëve, shpërndarjen e pagesave të prapambetura dhe borxhet mes kompanive të ardhshme. Një plan ristrukturimi, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, do të përmbajë vizionin në lidhje me zgjedhjen e kompanisë që do të kryejë furnizim universal për periudhën e tranzicionit në vazhdim. Do të përmbajë gjithashtu një strategji për ofertën publike, potencialisht që do të çonte në një privatizim të plotë të kompanisë furnizuese me një investitor strategjik që lehtësonte zbatimin e transformimit në një kompani biznesi private dhe konkurruese dhe një ofertë të pjesshme për publikun shqiptar për një pjesë minoritare të kompanisë DSO, me Këshillin e Ministrave të Shqipërisë duke ruajtur kontrollin mbi biznesin e rregulluar. Procesi i vlerësimit (hapat e nevojshëm/studimi paraprak) i të gjitha kompanive të reja që rezultojnë nga ristrukturimi i OSHEE-së do të kryhet nga një auditor i pavarur dhe raportet e tij miratohen nga MIE-ja dhe me raportimin në MFE dhe do të bëhet një vlerësim i qartë i tregut të kompanive, për një ofertë publike. Për më tepër, kompania OSHEE-DSO duhet të jetë e ndarë në përputhje me nenin 26 të direktivës së BE-së 2009/72/BE, që përfshin: - ndarjen ligjore të DSO-së nga aktivitetet e tjera (të bëra deri në fund të marsit 2018) të OSHEE-së që nuk kanë lidhje me shpërndarjen, - ndarjen funksionale të DSO-së për të siguruar pavarësinë e saj nga aktivitetet e tjera të OSHEE-së, veçanërisht furnizimin e çdo lloji, dhe - ndarjen financiare për të mbajtur llogari të ndara për aktivitetet e DSO. Përpara ofertës publike, duhet të zbatohet ndarja funksionale dhe të sigurohet që: - menaxhimi është me të vërtetë i ndarë dhe i pavarur, duke iu shmangur udhëzimeve DSO nga pjesë të tjera të ndërmarrjes në lidhje me aktivitetet e përditshme të DSO-së; - mbikëqyrja rregullatore përmes ERE-s është e garantuar; - krijohen dhe sigurohen të drejta të pavarura dhe efektive për vendimmarrje për DSO-në, p.sh. nëpërmjet burimeve të mjaftueshme; - miratohet një program pajtueshmërie, që përmban të paktën: rregullat e pajtueshmërisë, masat disiplinore kundër shkeljeve të rregullave të pajtueshmërisë, trajnimin për përputhshmërinë dhe miratimin e menaxhimit të vetë programit; - marrëveshjet e nivelit përkatës të shërbimit janë sipas parimeve të formimit të çmimeve të bazuara në treg; - komunikimi dhe vendosja e markës së kompanive të ristrukturuara shmangin çdo konfuzion të mundshëm mes tyre; - konfidencialiteti ruhet. Ndarja ligjore aktualisht e tanishme shënon një hap të rëndësishëm, por në mënyrë të qartë nuk është përbushur plotësisht sipas direktivave të Komunitetit të Energjisë. Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet se ky PRE është përgatitja e një oferte publike të OSHEE-së, sipas formës aktuale ligjore për ofertën publike, duke qenë një hap tjetër i natyrshëm, jashtë fushëveprimit të elementeve të politikave të reformës.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	ERE
Synimi i zbatimit	(Hapat e nevojshëm/studimi paraprak) dhe vlerësimi financiar i secilës prej kompanive të ristrukturuara dhe të ndara të OSHEE-së, të kryera nga auditori i pavarur
Matja e zbatimit	Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për planin e ristrukturimit për OSHEE-në. (nëse është i mundur kontrolli me notë pozitive i përputhshmërisë nga EnCS)

¹ Subjektet ekzekutues në këtë plan strategjik janë gjithashtu përgjegjës për raportimin sipas Skemës së Monitorimit të PBL-së.



Elementi 3 i reformës së politikave:

Titulli: Miratimi i një procesi matjeje dhe parashikimi

Subjekti ekzekutues	OSHEE, OST, KESH, ERE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Krijimi i një procesi dhe metodologjie të koordinuar të parashikimit, si dhe kërkesat teknike për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimeve
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës përmbledh zhvillimin, konsultimin dhe miratimin e një procesi të koordinuar të parashikimit të ngarkesës. Ky proces do të bazohet në profile të ngarkesës standarde, të tilla që të mbështesin hapjen e tregut me pakicë. Bazuar në procesin e parashikuar bashkërisht të përcaktuar për ngarkesën e furnizimit të kërkesës universale, duhet të zhvillohet një plan i mundshëm për matjen e zbatimit, me qëllim që të sqarohet se cilët matës do të instalohen së fundi dhe në cilën kohë. Megjithatë, duhet të theksohet se procesi i parashikimit dhe zgjerimi i matësve inteligjentë janë dy çështje të dallueshme. Për shembull, nuk është e domosdoshme që të ketë një zgjerim të matësve inteligjentë në të gjithë tregun për të arritur një parashikim të mirë. Ndërsa matësit inteligjentë rrisin cilësinë e parashikimit, ky nuk është një kusht i domosdoshëm për një parashikim të mirë që të ketë një qasje të përgjithshme në leximin e matësit inteligjent. Kështu, në Evropë, parashikimi i cilësisë së mirë ka ekzistuar dhe ende ekziston pa u mbështetur në të dhënat e matësve inteligjentë. Përveç që është parakusht për një hapje të mirë të tregut, futja e një procesi parashikimi mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të tregut dhe përmirëson efikasitetin e përgjithshëm të sistemit elektroenergjetik. Procesi i parashikimit për konsum duhet të synojë arritjen e të paktën një saktësie parashikuese në një afat ditor në advance prej 95%, (d.m.th. dallimin në mes parashikimit dhe faktit); 90% në një nivel përpara javës dhe 85% objektiv cilësie parashikuese për një periudhë kohore mujore. Ky parashikim do të përbëjë bazën për përcaktimin e kërkesës për energji që do të mbulohet nga furnizuesi i detyrimeve të shërbimit universal. Ai do të trajtohet i ndarë nga parashikimi i prodhimit për IPP-në (Prodhuesi i Pavarur i Energjisë). ERE do të miratojë metodologjinë themelore dhe procesin e dakordësuar si standard për përcaktimin e energjisë së shitur sipas detyrimit të shërbimit publik, veçanërisht për furnizimin universal.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE
Synimi i zbatimit	Miratimi i proceseve parashikuese dhe metodologjisë për parashikimin e ngarkesës sipas detyrimeve të shërbimit publik.
Matja e zbatimit	Përmbushja e objektivave të parashikimit të cilësisë sipas raportit të përbashkët të subjekteve zbatuese.

Elementi 4 i reformës së politikave:

Titulli: Zbatimi i hapjes së tregut dhe derregullimit të çmimeve

Subjekti ekzekutues	ERE, KM, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Zbatimi i vendimeve lidhur me hapat që duhen ndërmarrë për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimeve, si dhe zbatimin e kontratës universale të furnizimit ndërmjet OSHEE-së dhe KESH-it (siç është përcaktuar në shtojcën 1, të modelit të tregut të PX-së, i miratuar me vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave)
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës kërkon zbatimin e rregullave të tregut, të miratuara në dhjetor 2017, bazuar në modelin e tregut të miratuar në vitin 2016, - duke zbatuar detyrimin e shërbimit publik për shërbimin universal, duke vendosur kompensimin e duhur në pajtim me nenin 47 (7 & 8) PSL, - duke kufizuar detyrimin e shërbimit publik në të ardhmen për kompaninë furnizuese, - duke përmbajtur afatet që përcaktojnë cilat grupe të konsumatorëve janë të liberalizuar, në çfarë kohe dhe për të cilat grupet e konsumatorëve, furnizimi universal (dhe furnizimi i mjetit të fundit në përputhje me rrethanat) zbatohen, - duke synuar plotësisht derregullimin e furnizimit për të gjitha grupet e konsumatorëve, me përjashtim të ekonomive familjare, - duke reduktuar energjinë që do t'i dorëzohet US-PSO vetëm për të mbuluar familjet e lidhura me nivelin e tensionit të ulët. Vendimet sipas këtij elementi do të synojnë të nxisin likuiditetin e tregut, të përmbushin kërkesat për hapjen e tregut dhe derregullimin e plotë të çmimeve të konsumatorëve jofamiljarë në nivelin e tensionit të ulët. Aktualisht, kontrata mes KESH-OSHEE është një nga çështjet kryesore që pengon zbatimin e suksesshëm të reformës sektoriale. Duhet të theksohet se ky element i politikave të reformës është parashikuar të përforcojë afatet dhe mekanizmat për hapjen e tregut, siç është përcaktuar nga Këshilli i Ministrave në lidhje me ndërprerjen e kontrolluar të rregullimit të çmimeve për segmente të ndryshme të konsumatorëve. Për më tepër, ky element i politikave të reformës dhe të tjerë elemente përforcojnë nevojën për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Ky element i politikave të reformës kërkon miratimin e një strategjie afatgjatë, konkrete dhe të zbatueshme në formën e një vendimi të nivelit të lartë për çështjen e derregullimit që parashikon një fund të ardhshëm të kontratës afatgjatë të furnizimit KESH-OSHEE.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	KESH, OSHEE, OST, EnCS
Synimi i zbatimit	Të përmbushë kërkesat teknike për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimeve sipas dispozitave kalimtare të ligjit për sektorin e energjisë elektrike (PSL)
Matja e zbatimit	Me anë të kontrollit me nota pozitive të pajtueshmërisë nga EnCS (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë) ose me vendim të përshtatshëm të Këshillit të Ministrave

Elementi 5 i reformës së politikave:

Titulli: Krijimi i një tregu shkëmbimi të energjisë

Subjekti ekzekutues	OST, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Vendosja ligjore dhe funksionale e shkëmbimit të energjisë në Shqipëri (APEX) në përputhje me modelin e tregut të miratuar dhe rregullat e tregut
Përshkrim i detajuar	Zbatimi i ndryshimit të PSL në vitin 2018 mbi krijimin e APEX, sa më shpejt që të jetë e mundur brenda afatit të zbatimit të parë me fillimin e tregut të ditës në avancë, pas krijimit sa më shpejt të jetë e mundur edhe brenda afatit të parë të zbatimit. Më saktësisht, qëllimi përfundimtar i elementit të politikave të reformës është arritja e funksionimit të tregut të ditës në avancë.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE, ERE
Synimi i zbatimit	Bërja operationale e APEX
Matja e zbatimit	Kryerja e operationeve të tregut e ditës në avancë.



Elementi 6 i reformës së politikave:

Titulli: Zbatimi i mekanizmit dhe rregullave të balancimit të tregut

Subjekti ekzekutues	OST, ERE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Zbatimi i mekanizmit të balancimit të tregut, të përbërë nga prokurimi i hapur, transparent dhe jodiskriminues i rezervave balancuese dhe bazuar në ofertën më të mirë.
Përshkrim i detajuar	OST-ja do të krijojë një treg të balancuar funksional të energjisë elektrike, bazuar në praktikën e mira të BE-së. Kjo përfshin zbatimin e një përgjegjësie gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese të balancimit, krijimin e procedurave jodiskriminuese të prokurimit për rezervat e balancimit dhe një aktivizim të energjisë balancuese, bazuar sipas parimit të renditjes konkurrense, si dhe bazuar në një skemë adekuate kompensimi. Kjo do të përfshijë në rregullat dhe rregulloret përkatëse që krijojnë hapjen e përgjegjësisë balancuese deri te të gjithë prodhuesit e energjisë, pavarësisht nga: a) vëllimi i prodhimit të tyre; b) ndryshimi i tyre në prodhimin e energjisë elektrike; c) fleksibiliteti në përshtatjen e produktit të prodhimit; ose d) qëllimi dhe përdorimi i energjisë së prodhuar. Lidhjet midis çdo detyrimi të shërbimit publik dhe shërbimeve të balancimit do të ndërpriten dhe do të mbahen të ndara, megjithëse subjektet e angazhuara në PSO mbajnë detyrimin e tyre si një subjekt i palës përgjegjëse për balancimin që i nënshtrohen prokurimit konkurrues, të drejtë dhe transparent. Produktet e balancuara të standardizuara do të përcaktohen nga OST-ja. Produktet balancuese të përcaktuara, të siguruara në mënyrë të drejtë dhe transparente nga çdo palë përgjegjëse (përfshirë KESH-in, IPP-të, importet), duhet të përmbushin kërkesat e procesit të balancimit që rrjedhin nga proceset e kontrollit të frekuencave të OST-së, në përputhje me cilësinë e frekuencave ENTSO-E, duke caktuar dhe vendosur bazën për pagesën e kompensimit për ofruesit e shërbimeve balancuese. Kushtet dhe afatet që mbulojnë të gjitha kërkesat kontraktuale dhe teknike për palët përgjegjëse të balancimit dhe ofruesit e shërbimeve balancuese duhet të zhvillohen, konsultohen dhe miratohen nga OST-ja. Rregullimi dhe publikimi i rezervave balancuese të kërkuara për afatet kohore vjetore, mujore dhe javore, të shpallura në baza periodike, bazuar në një proces bazë dhe të standardizuar me të njëjtat afate kohore të cilat janë në themel të metodologjisë, që do t'i dorëzohet ERE-s.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE, OSHEE, KESH
Synimi i zbatimit	Kryerja e prokurimeve me bazë tregu, të shërbimeve balancuese dhe rezervave, si dhe vendosja e përgjegjësisë të barabarta, transparente dhe jodiskriminuese.
Matja e zbatimit	Vendosja e procesit të disbalancave të pagueshme nga të gjitha palët përgjegjëse të balancimit.



Elementi 7 i reformës së politikave:

Titulli: Krijimi i Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (RES) dhe transformimi i skemës *Feed-in-Tariffs*

Subjekti ekzekutues	ERE, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Krijimi i kuadrit institucional dhe rregullator për marketingun e drejtë, transparent dhe jodiskriminues të energjisë së rinovueshme.
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës përbëhet, së pari nga pjesa e detyrueshme dhe e domosdoshme, si dhe e dyta, si një objektiv i sugjeruar dhe i zbatueshëm. E para është transformimi i një skeme ekzistuese sipas të cilës paguhen aktorët për krijimin e “energjisë së gjelbër” të tyre, në mënyrë që të inkurajohen reduktimet e kostove teknologjike (<i>Feed-in-Tariff</i> - <i>FiT</i>s) për të gjithë prodhuesit energjisë së rinovueshme në kontratat për diferencë (CfD-të). Kjo do të mundësojë që prodhuesit e shesin energjinë e tyre të gjeneruar nëpërmjet tregut të organizuar në APEX. Ky transformim i FiT-ve në CfD promovon transparencën e kostove sistematike në lidhje me subvencionimin e prodhimit të të energjisë së rinovueshme, duke nxitur gjithashtu likuiditetin e tregut nëpërmjet ofertës konkurruese të RES në APEX. Elementi i politikave të reformës, si elementi i dytë, gjithashtu rekomandon caktimin e një institucioni, operatori i energjisë së rinovueshme, për të menaxhuar CfD-të, që rezultojnë nëpërmjet kontratave të standardizuara, duke marrë parasysh kapacitetin e institucioneve për të kryer proceset operacionale, financiare dhe kontraktuale. Operatori i energjisë së rinovueshme (REO) do të tregtojë prodhimin e energjisë elektrike nga RES, duke përfshirë tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar nga IPP-ja, në shkëmbimin e energjisë dhe të jetë përgjegjës për finalizimin e CfD-ve dhe për shlyerjen e detyrimeve financiare të tyre. Një program afatgjatë do të krijohet për operatorin e energjisë së rinovueshme, duke përcaktuar se cilat subjekte: - do të përfshihen në marketing; - do të kenë marrëdhënie kontraktuale; dhe - do të administrojnë pagesat e kompensimit për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë; me qëllim që të ketë transparencë të plotë mbi kostot për subvencionimin, vlerën e tregut të energjisë së prodhuar dhe shfaqjen e ndarë të kostove të skemës së subvencioneve për çdo kWh të konsumit për secilin grup përkatës që mbulon kostot (d.m.th. shtesën për energjinë e rinovueshme). Krijimi i REO-s rekomandohet me forcë, pasi shoqërohet me një numër të madh përfitimesh që shkojnë nga transparenca, likuiditeti, deri tek ulja e barrierave të tregut dhe kostove operacionale, veçanërisht për prodhuesit e vegjël të RES. Sipas këtij elementi të politikave të reformës do të merret një vendim lidhur me krijimin e REO-s, brenda vitit 2020. Përveç elementeve operacionale dhe institucionale, ERE do të miratojë të gjitha aktet e kërkuara nënligjore për zbatimin e ligjit për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, duke përfshirë përcaktimin e një çmimi referent për CfD-të që do të përdoret deri në themelimin e çmimit referues APEX është në dispozicion. Për më tepër, aktet nënligjore duhet të përfshijnë një strategji dhe metodologji për marketingun e energjisë së rinovueshme nga operatori i RES në një mënyrë që minimizon shtrembërimet e tregut dhe rrit konkurrencën e likuiditetin.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	OST, APEX
Synimi i zbatimit	Krijimi i Operatorit RES, transformimi i FiT në CfD.
Matja e zbatimit	Analizimi i publikimeve mbi subvencionet e RES dhe IPP



Elementi 8 i reformës së politikave:

Titulli: Ofertimi konkurrues për kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme

Subjekti ekzekutues	KM, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Zbatimi i ankandit të parë konkurrues dhe jodiskriminues për kapacitetet e reja të rinovueshme të prodhimit.
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës synon të mbështesë zhvillimin dhe realizimin e projekteve të rinovueshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të bazuar në ankand, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare. MIE-ja do të zhvillojë, konsultojë dhe zbatojë një kornizë për ndarjen e kapaciteteve të reja të rinovueshme, përmes një procesi konkurrues të ofertimit për investitorët privatë në lidhje me ndërtimin, operimin dhe zotërimin e projekteve të energjisë së rinovueshme në Shqipëri. Hartimi i skemës së ankandit për burimet e rinovueshme do të bëhet në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe do të synojë përkthimin e skemës “<i>feed in premium</i>” (instrument i politikave të bazuara në çmime, ku gjeneratorët e energjisë së rinovueshme janë paguar me një çmim premium, që është një pagesë krahas çmimit me shumicë) në kontratat për diferencë (CfD-të; skema “<i>sliding Premium</i>” (me nivele të ndryshueshme në varësi të evolucionit të çmimeve të tregut) paguar mbi çmimin e energjisë elektrike) me një çmim referent. Në rastin më të mirë, çmimi i referencës do të rrjedhë nga shkëmbimi i ri i përcaktuar për energjinë shqiptare, por së paku duhet të bazohet në një shpërndarës rajonal që përafron ngushtësisht me gjendjen e tregut shqiptar dhe ka likuiditet të mjaftueshëm në treg për të siguruar një sinjal informativ të çmimeve. Ankandet duhet të bazohen në planet për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, duke marrë parasysh (aty ku ekzistojnë): NREAP (Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme), TYNDP (Plani Kombëtar Dhjetë-Vjeçar Zhvillimor i Rrjetit), planet e DSO, Strategjinë Kombëtare të Energjisë, autoritetet vendore dhe planet e përgjithshme të zhvillimit të tregut për tregjet e ditës në avancë, brenda ditës dhe balancimit.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	ERE, OSHEE, OST, APEX, EBRD
Synimi i zbatimit	Kryerja e ankandit të parë
Matja e zbatimit	Publikimi i miratimit të skemës në “Fletoren zyrtare” të Republikës së Shqipërisë

Elementi 9 i reformës së politikave:

Titulli: Miratimi dhe zbatimi i skemës mbështetëse për konsumatorët në nevojë

Subjekti ekzekutues	KM, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Sigurimi që hapja e tregut dhe derregullimi i çmimeve të kenë ndikim minimal negativ ekonomik ndaj konsumatorëve në nevojë dhe familjeve që vuajnë nga liberalizimi i çmimit të energjisë elektrike. Përcaktimi i skemës së mbështetjes për këto grupe.
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës do të përfshijë zhvillimin dhe zbatimin e një skeme mbështetëse që synon dhe mbron konsumatorët dhe familjet në nevojë, që do të vuanin nga liberalizimi i çmimit të energjisë. Përderisa dihet, se një formë e skemës së propozuar tashmë ekziston ose është pasqyruar në skemat ekzistuese të mbështetjes sociale, elementi i politikave të reformës është llogaritur si masë plotësuese në hapësirën e lartpërmendur dhe me synimin për të siguruar që çdo skemë mbështetëse, ekzistuese ose e re, është hartuar në mënyrë transparente dhe se çdo masë, e re apo ekzistuese, ka sa më pak efekt në treg të jetë e mundur. Kjo, mes të tjerash, parashikon se asnjë skemë nuk përdoret si skemë e subvencionimit për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, por përdoret vetëm për të mbështetur segmentin e konsumatorëve në nevojë.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MFE, ERE
Synimi i zbatimit	Paraqitja e skemës së mbështetjes sociale për zbutjen e ndikimeve potencialisht të pafavorshme të derregullimit të çmimeve në familjet me të ardhura të ulëta.
Matja e zbatimit	Publikimi i miratimit të skemës në “Fletoren Zyrtare” të Republikës së Shqipërisë



Elementi 10 i reformës së politikave:

Titulli: Finalizimi i akteve nënligjore në përputhje me legjislacionin e komunitetit të energjisë (EnC *acquis*)

Subjekti ekzekutues	ERE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Krijimi i kuadrit rregullator përmes akteve nënligjore që janë në përputhje me aktin e Komunitetit të Energjisë dhe ligjet e aplikueshme shqiptare.
Përshkrim i detajuar	ERE e mbështetur nga OST-ja, OSHEE-ja dhe KESH-i në rolin e tyre si pjesëmarrës kyç në treg, zhvillon, konsultohet në veçanti me këto shoqëri publike dhe miraton e kërkon opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për të gjitha aktet nënligjore që janë ende në pritje për t'u zbatuar në pajtim me ligjin për sektorin e energjisë elektrike. Për më tepër, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të kryejë kontrolle përputhshmërie për të cilat rezultati do të jetë pozitiv ose ndryshe legjislacioni përkatës nënligjor do të rihartohet derisa të gjykohet në pajtueshmëri të plotë. Kjo kërkesë e kontrollit pozitiv të përputhshmërisë do të zbatohet edhe për legjislacionin e nënligjor ekzistues, që deri më tani është gjetur nga Sekretariati si jo e pajtueshme. Një listë gjithëpërfshirëse e legjislacionit relevant, përfshirë edhe një qasje të Sekretariatit, mund të gjenden në faqen e internetit në vijim: https://www.energy-community.org/implementation/Albania/secondary.html
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE, OST, OSHEE, KESH, EnCS (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë)
Synimi i zbatimit	Miratimi i një numri të konsiderueshëm dhe të përshtatshëm të akteve nënligjore të kërkuara sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike PSL
Matja e zbatimit	Miratimi i numrit të rëndësishëm dhe të përshtatshëm të akteve nënligjore që mungojnë sipas PSL dhe në përputhje me listën e kontrollit të EnC-së

Elementi 11 i reformës së politikave:

Titulli: Rritja e kompetencave dhe pavarësia e ERE-s

Subjekti ekzekutues	ERE, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Forcimi i një rregullatori të pavarur i cili është në përputhje me Direktivën e BE-së 2009/72/KE
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës përbëhet nga miratimi i legjislacionit dhe rregulloreve të nevojshme, kompetencë e ERE-s, si një rregullator i fortë i pavarur në përputhje me paketën e tretë të energjisë të BE-së (Direktiva 2009/72/KE Kapitulli IX). Duke konsideruar se legjislacioni aktual në fuqi përmbush pjesën më të madhe të kërkesave të përcaktuara në Direktivën e BE-së, në vijim renditen elementet kryesore që do të ndihmojnë në ngushtimin e hendekut ndaj këtyre kërkesave: Fuqia e sanksionimit. T'i jepet ERE-s fuqi mjaftueshëm e fortë sanksionuese, që është e përshtatshme për rolin e saj në mjedisin e ri të tregut. Burimet operacionale. Rregullatorit t'i jepen burime të mjaftueshme njerëzore për të ekzekutuar kompetencat e reja në mënyrë efikase dhe të përshtatshme, duke përfshirë përmirësimin bazuar në kapacitetin dhe njohuritë. Bashkëpunimi ndërkombëtar. Të rritet angazhimi dhe bashkëpunimi i ERE-s në nivel ndërkombëtar, veçanërisht me rregullatorët dhe shoqatat rregullatore. Kjo do të bëhet në frymën e shkëmbimit të informacionit dhe njohurive për të lejuar ERE-n që të zbatojë në mënyrë efikase praktikën më të mira ndërkombëtare të përshtatshme për tregun e sapokrijuar të organizuar dhe rolin e tij brenda saj. Zbatimi. Pa paragjykuar gjendjen e tanishme, është e domosdoshme që elementet e legjislacionit dhe rregulloreve shqiptare të miratuara, që kanë të bëjnë me rregullatorin sipas Direktivës së BE-së 2009/72/KE të zbatohen në masë të plotë dhe pa kufizime. Zbatimi i rregullave në fuqi të cilat nuk zbatohen do të jetë një nga sfidat kryesore për ERE-n në këtë drejtim. Autonomia e menaxhimit. Punonjësit e ERE-s do të çlirohen nga zbatimi i skemës për shpërblimin e nëpunësit civil dhe nivelet e pagave duhet të orientohen sipas treguesve që zbatohen në biznesin e rregulluar.



Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE
Synimi i zbatimit	Rritja e fuqive sanksionuese të ERE-s
Matja e zbatimit	Për sa i përket lejimit të kohës, duhet të shqyrtohet nga EnCS, ose nga vlerësimi i bazuar në standardet dhe parimet e EnC dhe potencialisht, nëse është e nevojshme, përmes ndryshimeve të PSL

Afati i dytë i zbatimit: 2019/2020

Tabela në vijim ofron një pasqyrë të elementeve të politikave të reformës, të propozuara për afatin e dytë kohor të zbatimit nga tremujori i katërt i 2019 deri në tremujorin e tretë 2020.

Nr.	Emri	Përshkrimi	Subjekti ekzekutues
12	Skema e re tarifore	Miratimi i skemës (ave) më transparente, jodiskriminuese dhe të drejta të tarifave që janë të duhura dhe të përshtatshme për një treg të lirë e të organizuar, ku çmimi i energjisë elektrike bazohet në kërkesën për të dhe investimet e nevojshme.	ERE
13	Bashkim i tregut të ditës në avancë me tregjet e tjera	Bashkimi i tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë me tregjet fqinje	ERE, APEX, OST
14	Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për KESH-in	Përcaktimi i rolit në treg në të ardhmen i KESH-it, si gjatë periudhës së tranzicionit ashtu edhe në periudhën afatgjatë	MIE, KESH
15	Plani Kombëtar 10-vjeçar Zhvillimor i Rrjetit	Miratimi nga OST-ja i një Plani Kombëtar 10-vjeçar Zhvillimor të Rrjetit (TYNDP), në varësi të miratimit të ERE-s	OST, ERE
16	Prokurimi i integruar i të gjitha humbjeve	Krijimi nga OST-ja (ose më mirë nëse është e zbatueshme të përgatisë dhe të propozojë për miratim në ERE) i një procesi të vetëm për prokurimin e energjisë për humbjet e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes në APEX	OST, ERE
17	ERE arrin statusin e vëzhguesit në ACER	ERE të bëhet një vëzhgues në Organizatën Panevropiane për Rregullatorët (ACER-Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë)	ERE, MIE
18	Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për OSHEE-në	Përkufizimi i rolit të ardhshëm të OSHEE-së (në veçanti elementit të DSO) në treg si gjatë një periudhe tranzicioni dhe afatgjatë	MIE, OSHEE

Tabela 2: Vështrim i përgjithshëm i elementeve të politikave të reformës për afatin e dytë kohor të zbatimit

Elementi 12 i reformës së politikave:

Titulli: Skema e re tarifore

Subjekti ekzekutues	ERE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Miratimi i skemës(ave) më transparente, jodiskriminuese dhe tarifave të përshtatshme për një treg të lirë e të organizuar, ku çmimi i energjisë elektrike bazohet në kërkesën për të dhe investimet e nevojshme.
Përshkrim i detajuar	Një kuadër i vetëm në formën e një skeme të re tarifore do të duhet të zhvillohet që, ndër të tjera të tregojë të gjitha ndërvlerësit e tarifave. Për këtë arsye rrit transparencën për përdoruesit e fundit dhe palët e interesuara. Struktura e re e tarifave që reflekton koston (bazuar në bazën e aseteve të rregulluara) do të identifikojë kostot specifike për energjinë (si të prodhuara nga RES dhe IPP-të dhe të blera në tregun me shumicë), shërbimet e rrjetit (rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes), humbjet e rrjetit, si dhe pagesën e furnizimit. Elementet e reja të tarifave, metodologjitë e tyre të llogaritjes dhe rezultatet e llogaritjes duhet të detajohen në faturat e energjisë elektrike të konsumatorit të fundit dhe të publikohen nga ERE në rubrika të veçanta. Tarifat e reja në natyrën e tyre nuk do të diskriminojnë palët e interesuara të tregut. Pra, së bashku me transparencën, regjimi i ri tarifor do të rritë likuiditetin e tregut, ndër të tjera, lehtësimin e hyrjes në treg. Për më tepër, regjimi i ri tarifor duhet të kontribuojë në përmirësimin e subvencionimit të vazhdueshëm (duke përfshirë edhe subvencionimin e ndërsjellë) dhe koston e lidhur me to.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	KESH, OST, OSHEE
Synimi i zbatimit	Struktura e tarifave që lejon dhe nxit hapjen e tregut
Matja e zbatimit	Krahasimi i ri me tarifën e vjetra

Elementi 13 i reformës së politikave:

Titulli: Bashkim i tregut të ditës në avancë me tregjet e tjera

Subjekti ekzekutues	ERE, APEX, OST
Përshkrimi i nivelit të lartë	Bashkimi i tregjeve të energjisë elektrike të ditës në avancë me tregjet fqinje
Përshkrim i detajuar	Në përputhje me modelin e synuar të BE-së për marrëveshjet e tregtisë ndërkufitare të energjisë elektrike për ditën në avancë, subjektet zbatuese do të ndjekin proceset operationale dhe financiare duke përfshirë të gjitha rregullimet e nevojshme kontraktuale dhe rregullatore për të bashkuar tregun e organizuar të ditës në avancë të Shqipërisë me ato të vendeve fqinje, duke përdorur një metodologji të nënkuptuar të bashkimit të çmimeve. Kjo do të bëhet në frymën e nxitjes së likuiditetit të tregut përmes mundësisë dhe nxitjes së tregtisë duke zvogëluar diferencat e panevojshme të çmimeve, maksimizimin e vlerës së energjisë së prodhuar, optimizimin e mundësive tregtare dhe përmirësimin e menaxhimit të portofolit. Gjithashtu, duhet të avancohet me sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike në Shqipëri në lidhje me iniciativat afatgjata të investimeve, si dhe në afat të shkurtër nëpërmjet shfrytëzimit të mundësisë së gjenerimit të elektroenergjisë përmes hidrokarbureve.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE
Synimi i zbatimit	(Go-Live) i tregjeve të bashkuara të ditës në avancë
Matja e zbatimit	Analiza e ofertave nga pjesëmarrësit e tregut

Elementi 14 i reformës së politikave:

Titulli: Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për KESH-in

Subjekti ekzekutues	MIE, KESH
Përshkrimi i nivelit të lartë	Përcaktimi i rolit në treg në të ardhmen i KESH-it, si gjatë periudhës së tranzicionit ashtu edhe në periudhën afatgjatë.
Përshkrim i detajuar	Vendimi i kërkuar synon të bëjë KESH-in një operator tregu si çdo tjetër, me përjashtim të faktit se ai është në pronësi të shtetit, për të mos qenë i diskriminuar pozitivisht apo negativisht në lidhje me aktivitetet në treg. Vendimi duhet të jetë në përputhje me modelin e tregut dhe kërkesat e tij për një balancim ndërmjet palëve përgjegjëse dhe legjislacionin e Komunitetit të Energjisë. Për më tepër, vendimi ndër të tjera do të shndërrojë KESH-in në plan afatgjatë, si një kompani që operon në treg të hapur, që nuk përdor statusin e monopolit, që rrjedh nga trashëgimia si shoqëri publike. Duhet të mbahet parasysh se, fitimet e ardhme dhe të mundshme neto të KESH-it mund të përdoren për subvencionimin e furnizimit me energji për tarifën e konsumatorit fundor. Megjithatë, çdo subvencionim i tillë duhet të ndodhë në mënyrë transparente nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mundësisht jo drejtpërsëdrejti përmes buxhetit të KESH-it dhe pa vështirësuar konkurrencën, likuiditetin dhe formimin e çmimit të lirë në treg, duke synuar minimizimin e çdo shtrembërimit të tregut. Kjo nga ana tjetër do të lejojë që KESH-i të veprojë si palë përgjegjëse për balancën e rezervave, furnizuesin, ofruesin e shërbimit të balancimit dhe/ose agregat si çdo operator tjetër i tregut.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	ERE, OSHEE
Synimi i zbatimit	Miratimi i vendimit të një perspektive strategjike për KESH-in
Matja e zbatimit	Vlerësimi i vendimit lidhur me mosdiskriminimin e operacioneve të ardhshme të KESH-it

Elementi 15 i reformës së politikave:

Titulli: Plani Kombëtar 10-vjeçar Zhvillimor i Rrjetit

Subjekti ekzekutues	OST, ERE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Miratimi nga OST i një Plani Kombëtar 10-vjeçar Zhvillimor të Rrjetit (TYNDP), në varësi të miratimit të ERE-s
Përshkrim i detajuar	OST-ja do të zhvillojë ndërsa ERE-ja do të miratojë planin e zhvillimit të transmetimit sipas nenit 60, të ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe nenit 22, Direktiva 2009/72/KE. Ky TYNDP, ndër të tjera, do të mbulojë fushat në vijim: - Balanca e kërkesës dhe ofertës. Një pasqyrë e kërkesës dhe ofertës ekzistuese, si dhe parashikimi i evolucionit të kësaj kërkesë dhe furnizimi - Miksimi i gjenerimit. Një analizë e hollësishme e miksimit aktual të prodhimit dhe parashikim të evolucionit të tij - Flukset e importit dhe eksportit. Prezantim i situatës aktuale në lidhje me flukset tregtare dhe evoluimin e tyre gjatë dhjetë viteve të ardhshme, duke përfshirë ndikimin dhe përdorimin e shkëmbimit të energjisë elektrike brenda kontekstit të tregtisë. - Infrastruktura e transmetimit. Identifikimi i infrastrukturës kryesore të transmetimit që duhet të ndërtohet ose përmirësohet gjatë dhjetë viteve të ardhme, si dhe infrastrukturës që nevojitet për integrimin e të gjithë infrastrukturës së transmetimit në sistemin SCADA/EMS. Kjo duhet të përfshijë një plan të detajuar të kohës dhe afatit të investimit, si dhe një plan të detajuar, që tashmë është marrë vendimi për investime dhe të cilat janë ende të pazgjidhura. - Vizioni strategjik. Në TYNDP, OST do të ofrojë një vizion strategjik mbi zhvillimin e planit të transmetimit, duke marrë në konsideratë në veçanti efikasitetin e energjisë, integrimin e RES-it në sistem, rolin dhe ndikimin e shkëmbimit të energjisë, tregtinë ndërkufitare. - Pajtueshmëria. TYNDP duhet të përfshijë një seksion mbi përputhshmërinë e tij me TYNDP jo të detyrueshme në nivel komunitar, të zhvilluar nga ENTSO-E. Procesi i zhvillimit, hartimit, konsultimit dhe miratimit të TYNDP duhet të bëhet në mënyrë transparente, të hapur, jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të gjithë aktorët relevantë të kenë mundësinë të japin të dhëna.



Subjektet që u ofrohet lehtësim	Prodhuësit, konsumatorët e fundit të mëdhenj
Synimi i zbatimit	Miratimi i TYNDP nga OST, në varësi të miratimit të ERE-s
Matja e zbatimit	Rishikimi i TYNDP

Elementi 16 i reformës së politikave:

Titulli: Prokurimi i integruar i të gjitha humbjeve

Subjekti ekzekutues	OST, ERE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Krijimi nga OST-ja (ose më mirë nëse është e zbatueshme të përgatisë dhe të propozojë për miratim në ERE) i një procesi të vetëm për prokurimin e energjisë për humbjet e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes në APEX
Përshkrim i detajuar	OST do të krijojë një proces të integruar për prokurimin e humbjeve për të gjithë operatorët e rrjetit (transmetimi dhe shpërndarja), duke përfshirë rrjetin e transmetimit, përmes prokurimit të energjisë në APEX. Energjia e prokuruar mbulon të gjitha humbjet në tërë rrjetin, atë të transmetimit dhe atë të shpërndarjes. Në këtë mënyrë, likuiditeti në anën e kërkesës ofrohet për tregun, duke zbatuar prokurimin e humbjeve në mënyrë transparente, konkurruese dhe efikase. Duhet të krijohet dhe publikohet një çmim mesatar i qartë për humbjet bazuar në prokurimin e humbjeve në APEX.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	MIE, OSHEE
Synimi i zbatimit	Prokurimi i gjithë energjisë për mbulimin e humbjeve në Shqipëri në një proces të vetëm
Matja e zbatimit	Analiza e ofertave të dorëzuara në APEX

Elementi 17 i reformës së politikave:

Titulli: ERE arrin statusin e vëzhguesit në ACER

Subjekti ekzekutues	ERE, MIE
Përshkrimi i nivelit të lartë	ERE të bëhet një vëzhgues në Organizatën Panevropiane për Rregullatorët (ACER-Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë)
Përshkrim i detajuar	Ky element i politikave të reformës përbëhet nga aplikimi dhe arritja e statusit të vëzhguesit në kuadër të ACER, i kushtëzuar nga një opinion me nota pozitive nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Kjo PRE përbëhet nga aplikimi dhe dhënia e statusit të vëzhguesit në grupin e punës të gazit dhe energjisë elektrike të ACER. Aplikimi përfshin kushte të ndryshme që duhet të përmbushen, nga të cilat tre të rëndësishmet janë: a) pajtueshmëria ligjore dhe zbatimi i vazhdueshëm; b) zbatimi i paketës së tretë të energjisë së BE-së; si dhe c) krijimi dhe funksionimi i vazhdueshëm i një rregullatori të fortë e të pavarur. Përputhshmëria me kërkesat duhet të monitorohet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	ACER, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Komisioni Evropian
Synimi i zbatimit	Marrja e statusit të vëzhguesit në ACER
Matja e zbatimit	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ACER dhe Komisioni Evropian



Elementi 18 i Reformës së Politikave:

Titulli: Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për OSHEE-në

Subjekti ekzekutues	MIE, OSHEE
Përshkrimi i nivelit të lartë	Përkufizimi i rolit të ardhshëm të OSHEE-së (në veçanti elementit të DSO) në treg si gjatë një periudhe tranzicioni, edhe afatgjatë.
Përshkrim i detajuar	Vendimi i kërkuar do të synojë që OSHEE-ja të bëhet një operator efikas i sistemit të shpërndarjes dhe një pjesëmarrës tregu. Vendimi duhet të jetë në përputhje me modelin e tregut dhe kërkesat e tij për DSO-në, si dhe për legjislacionin e Komunitetit të Energjisë, siç është pasqyruar në kontekstin e ligjeve shqiptare. Vendimi, ndër të tjera, duhet të shndërrojë OSHEE-në në periudhën afatgjatë si një shoqëri, që operon në treg në kushte konkurruese dhe që nuk përdor statusin e monopolit, i cili rrjedh nga trashëgimia si shoqëri publike.
Subjektet që u ofrohet lehtësim	ERE
Synimi i zbatimit	Miratimi i vendimit për një perspektivë strategjike për OSHEE-në
Matja e zbatimit	Vlerësimi i vendimit lidhur me mosdiskriminimin e operimit të ardhshëm të OSHEE-së nga ERE

Ndërvarësitë mes elementeve të politikave të reformës

Tabela më poshtë thekson ndërvarësitë e elementeve të politikave të reformës, me qëllim lehtësimin e zbatimit.

Nr.	Elementi i reformës së politikave	Parakusht për PRE	Në varësi të PRE
1	Marrëveshja mbi vonesat dhe përmirësimi i pagesave nga subjektet publike	2, 14, 18	-
2	Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE-së	3, 4, 9, 11, 12	4, 1
3	Miratimi i një procesi matjeje dhe parashikimi	4, 16	2
4	Zbatimi i hapjes së tregut dhe liberalizimi i çmimeve	2, 5, 14, 18	2, 3, 6
5	Krijimi i një tregu shkëmbimi të energjisë	(8), 13, 14, 18	4, 6
6	Zbatimi i mekanizmit dhe rregullave të balancimit të tregut	4, 5	10
7	Krijimi i operatorit RES dhe transformimi i <i>Feed-in-Tariffs</i>	8	(5)
8	Ofertimi konkurrues për kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme	-	7
9	Miratimi dhe zbatimi i skemës mbështetëse për konsumatorët në nevojë	-	2
10	Finalizimi i akteve nënligjore në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë	6, 13, 14, 17, 18	-
11	Rritja e kompetencave dhe pavarësisë së ERE-s	17	2
12	Skema e re tarifore	14, 18	2
13	Bashkim i tregut të ditës në avancë me tregjet e tjera	-	5, 10
14	Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për KESH-in	18	1, 4, 5, 10, 12
15	Plani Kombëtar 10-vjeçar zhvillimor i rrjetit	-	-
16	Prokurimi i integruar i të gjitha humbjeve	-	3
17	ERE arrin statusin e vëzhguesit në ACER	-	10, 11
18	Miratimi i një perspektive të qartë strategjike për OSHEE-në	-	1, 4, 5, 10, 12, 14

Tabela 3: Ndërvaresitë midis elementeve të politikave të reformës të të dyja periudhave të zbatimit

Sa më poshtë vijon është një paraqitje grafike e ndërvaresive ndërmjet elementeve të politikave të reformës.




Figura 1. Përfaqësimi grafik i ndërvaresive të PRE-së

Së fundi, tabela në vijim thekson, bazuar në ndërvaresitë e paraqitura në tabelën 3 dhe figurën 1 më sipër, kohën dhe kohëzgjatjen e elementeve të politikave të reformës dhe aktorët kryesorë shqiptarë përgjegjës për to. Qelizat e mbushura blu tregojnë njëfarë fleksibiliteti sa i përket fillimit, kohëzgjatjes ose përfundimit.

Numri i PRE-ve	Afati i parë i zbatimit				Afati i dytë i zbatimit				Paketa e punës	Pala përgjegjëse
	4Q18	1Q19	2Q19	3Q19	4Q19	1Q20	2Q20	3Q20		
1									1	KM
10									2	ERE
2									3	MIF
3									4	OST
4									5	MIE
6									6	KM
5									7	ERE
7									8	MIE
8									9	OST
9									10	ERE
11										
17										
12										
14										
18										
16										
15										
13										

Figura 2: Afatet e pritshme të zbatimit të rrjedhës së punës

**UDHËZIM**

Nr. 37, datë 4.12.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË
UDHËZIMIN NR. 29, DATË 10.9.2018,
“PËR VEPRIMTARINË DHE
NGARKESËN MËSIMORE TË
PERSONELIT AKADEMIK NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 8 të nenit 59 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZON:

Në kreun II, të udhëzimit nr. 29, datë 10.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 6 riformulohet si vijon:

“6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë përmban deri në 3 (tri) lëndë në semestër, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë.”.

b) Në pikën 12, në fund të shkronjës “e”, të shtohet:

“Ndjekja e 1 orë praktike spitalore në shkenca mjekësore teknike është 0.5 orë mësimore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla**

UDHËZIM

Nr. 861, datë 13.12.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 5628, DATË 18.11.2016, “PËR
MIRATIMIN E RRJETIT TË LINJAVE
NDËRQYTETËSE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në rrjetin e linjave ndërqytetëse të përcaktuara në aneksin 1, të udhëzimit nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, shtohen linjat ndërqytetëse sipas shtojcës A të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjijnuri**

SHTOJCA A

**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE
PËR BASHKINË SHIJAK**

Nr.	Linja kryesore	Nr. i orareve
1	Shijak–Korçë–Shijak	2 (dy)

**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE
PËR BASHKINË KORÇË**

Nr.	Linja kryesore	Nr. i orareve
1	Korçë–Kamzë–Korçë	3 (tre)

**RRJETI I LINJAVE NDËRQYTETËSE
PËR BASHKINË TIRANË**

Nr.	Linja kryesore	Nr. i orareve
1	Tiranë–Durrës–Tiranë (me kalim nga Ndroqi, Plepa)	20 (njëzet)

**VENDIM****Nr. 242, datë 12.12.2018****PËR SHPALLJEN E KANDIDATËVE
FITUES PËR ANËTARË GJYQTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Në mbështetje të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga anëtarët si vijon:

1. Durim Kadiu, kryetar;
2. Engert Pëllumbi, anëtar;
3. Florjan Kalaja, anëtar.

Bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,

VENDOSI:

1. Të shpallë emrat e kandidatëve fitues për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:

1) Z. Medi Bici shpallet fitues për Gjykatën e Lartë;

2) Z. Ilir Toska shpallet fitues për Gjykatën e Apelit Tiranë;

3) Znj. Brikena Ukperaj shpallet fitues për Gjykatën e Apelit jashtë Tiranës;

4) Z. Dritan Hallunaj shpallet fitues për Gjykatën e shkallës së parë Tiranë;

5) Znj. Brunilda Kadi shpallet fitues për Gjykatën e shkallës së parë Tiranë;

6) Znj. Marçela Shehu shpallet fitues për Gjykatën e shkallës së parë jashtë Tiranës.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I VOTIMIT**Durim Kadiu, Engert Pëllumbi,
Florjan Kalaja**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë